# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449368**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Niveli i dytë më i ulët i të gjitha kohërave, rritja e normave të interesit dhe forcimi i Lekut “godasin” sërish bilancin e Bankës së Shqipërisë |
| ADRESA | https://newsbomb.al/ekonomi/niveli-i-dyte-me-i-ulet-i-te-gjitha-koherave-rritja-e-normave-te-interes-i401362 |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 13:38:40 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 13:34:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 456dcd825f3234321ba72e5b228467f12de3c273a1a8a805d76949b9ebb464e2 |
| TEKSTI | e744f410edc3854bf6b71d03cd5e4dd42aef72bc5974853811222d19b62f3f4e |
| PAMJA | c8da608e297c4689f2a6bca7fd5532efb7f3982c08cd85184ee80070bcc70121 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 1bbd335b8d779923f28531e4b7f6797a01b5d86d0a2af4b29df807235cfaf091 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 9235283646fceb4f2e036f737b53ac1b0d6441cb2e31166fde86e3118480b863 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/1bbd335b8d779923f28531e4b7f6797a01b5d86d0a2af4b29df807235cfaf091

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Ekonomi

16 Shtator 2026, 15:34

# Niveli i dytë më i ulët i të gjitha kohërave, rritja e normave të interesit dhe forcimi i Lekut "godasin" sërish bilancin e Bankës së Shqipërisë

Shkruar nga **Newsbomb**




**Banka e Shqiperise**

Rritja e normave të interesit dhe forcimi i mëtejshëm i Lekut në kursin e këmbimit kanë përkeqësuar përsëri bilancin e Bankës së Shqipërisë në muajt e fundit. Sipas statistikave zyrtare, në fund të muajit gusht vlera e kapitalit të Bankës së Shqipërisë ishte negativ në vlerën e 25.4 miliardë lekëve.

Ky është niveli më i ulët në tre vitet e fundit dhe niveli i dytë më i ulët i të gjitha kohërave.

Që prej fillimit të vitit 2023, kur nisi rritja e shpejtë e normave të interesit pas shpërthimit të Luftës në Ukrainë, gjendja e kapitalit të Bankës së Shqipërisë ka qëndruar kryesisht në vlera negative. Veç efektit të rritjes së normave të interesit, një ndikim të fortë ka dhënë edhe zhvlerësimi i rezervës gjithnjë e më të madhe valutore të mbajtur nga Banka Qendrore.

Banka e Shqipërisë mban një rezervë të madhe në valutë të huaj, si mjet i domosdoshëm për të përballuar nevojat emergjente që mund të ketë ekonomia dhe sektori financiar.

Duke qenë se bilanci i Bankës së Shqipërisë raportohet në monedhën vendase, forcimi i vazhdueshëm i Lekut në kursin e këmbimit e ka ulur vlerën në monedhën vendase të rezervave të mbajtura në valutë të huaj.

Revista




Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit


Rajoni
"A ka rrezik të vdesë në burg Hashim Thaçi?" Milaim Zeka shpërthen në lot pas pyetjes së vajzës për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së


Politikë
Vendimi për ish-krerët e UÇK-së, Spiropali reagon e revoltuar: U dënuan nga Serbia! Shqipëria dhe Kosova të reagojnë menjëherë

Zbulo më shumë artikuj

Për vitin e kaluar, humbjet neto nga ndryshimet e kurseve të këmbimit kishin vlerën e 24.1 miliardë lekëve. Humbjet në këtë zë u rritën me 79% krahasuar me një vit më parë, raporton Monitor.al.

Duke parë tendencat e kursit të këmbimit gjatë këtij viti, gjasat janë që ky efekt negativ të thellohet. Euro ka arritur nivele të reja minimale historike, ndërsa ritmi i rënies së kursit është përshpejtuar krahasuar me vitin e kaluar.

Në mesin e muajit shtator, zhvlerësimi i Euros ndaj Lekut ka arritur pranë nivelit të 5.5% me bazë vjetore. Zhvlerësimi i Euros dhe i valutave të tjera të huaja reflektohet në zgjerimin e humbjeve nga ndryshimi i kursit.

Sipas të dhënave më të fundit, në korrik të këtij viti vlera e rezervës valutore arriti në gati 8.2 miliardë euro, në rritje vjetore me 18.6%.

Të dhënat e deritanishme zyrtare dhe ato të tërthorta tregojnë se Banka e Shqipërisë po vazhdon blerjet e valutës në sasi të mëdha edhe këtë vit. Për tremujorin e parë, ato kishin vlerën e 140 milionë eurove, 320% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë, pas muajit maj, zgjerimi i shpejtë i bilancit të BSH mund të jetë një tregues i rritjes së ndjeshme të blerjeve të valutës.

Pavarësisht se gjendja e kapitalit ngelet negativ, Banka e Shqipërisë vlerëson se mbetet e mirëkapitalizuar në bazë të kapitalit të realizuar, edhe pse forcimi i monedhës Lek përkundrejt monedhave ku është investuar rezerva valutore, ka gërryer kapitalin e saj.

Sipas Bankës së Shqipërisë, fitimet apo humbjet nga rivlerësimi janë të luhatshme dhe i nënshtrohen faktorëve ekonomikë jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të Bankës së Shqipërisë, që mund të kthehen me ndryshimin e kushteve ekonomike botërore.

## Sondazh

Poll


## Lexo gjithashtu




E Mërkurë 07:41 Newsbomb

## Shtrenjtimi i tarifave "zbraz" bankat e shkollave private, ku po shkojnë nxënësit



Ekonomi

6 milionë euro evazion fiskal dhe 3.5



Ekonomi

Dyfishohet bonusi për pensionistët,

milionë euro fatura fiktive, Tatimet dhe Guardia di Finanza zbulojnë skemën transnacionale të mashtrimit

E Martë 17:47

nga 1 janari 2027 mbështetja mujore rritet për të gjitha kategoritë

E Martë 17:00




E Martë 16:45

## Një në katër të punësuar merr pagë minimale, rritet pesha e pagave më të larta



Ekonomi

Shqipëria një ndër vendet më të shtrenjta të rajonit, TVSH-ja e ushqimeve dhe mungesa e prodhimit vendas rrisin koston për qytetarët

E Diel 07:52



Ekonomi

Bizneset përsëri kundër projektligjit për anëtarësim me detyrim në Dhomën Ekonomike Kombëtare

E Shtunë 07:41




E Premte 17:16

## 9 hektarë tokë shtetërore për 1 euro, Qeveria miraton investimin strategjik në Durrës









Ekonomi

Qeveria i jep kompetenca Komisionit të Prokurimit Publik të pezullojë dhe shpallë të pavlefshme kontratat PPP

E Premte 16:05

Ekonomi

Euro prek minimum të ri, thyen për herë të parë edhe pragun e 92 lekëve

E Premte 15:17




E Enjte 18:27

## Rekord i ri historik, emigrantët dërguan në Shqipëri 621 miliardë lekë në 6-mujorin e parë të vitit





Ekonomi

Buxheti arkëtoi 18 milionë euro më shumë në mars-korrik, vetëm nga shtrenjtimi i naftës dhe benzinës

E Enjte 08:13 Newsbomb

Ekonomi

Euro në rënie edhe për shtatorin, pranë thyerjes së kufirit të 92 lekëve

E Mërkurë 15:50




E Mërkurë 08:31

## Për çfarë i shpenzojnë paratë shqiptarët




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.